

Mundësi për aplikim të bashkive në thirrjen “CEI Know-how Exchange Programme – KEP 2026”

Synimi i Thirrjes:

Thirrja synon të mbështesë projekte për transferim njohurish, ekspertize dhe praktikash të mira nga vende të BE-së drejt vendeve jo-BE anëtare të CEI, për të ndihmuar procesin e integritit evropian, reformat dhe përafrimin me standardet/acquis të BE-së. Shqipëria është vend i pranueshëm si përfitues.

Fushat e veprimit të thirrjes:

Projektet duhet të lidhen me sektorët e përcaktuar në CEI Plan of Action 2024–2026 dhe të kontribuojnë në integrimin në BE, zhvillimin institucional, kapacitetet teknike, reformat, dokumentet strategjike, bashkëpunimin rajonal dhe zbatimin e standardeve europiane.

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

Bashkitë janë të pranueshme si institucione publike.

Konsorciumi duhet të ketë të paktën 2 partnerë:

1. Një know-how provider (subjekt ofrues) nga një shtet anëtar i BE-së, anëtar në CEI.
2. Një know-how beneficiary (subjekt përfitues) nga një shtet kandidat në BE, anëtar në CEI.

Një bashki shqiptare mund të jetë përfituese.

Aktivitete të pranueshme:

Aktivitetet e pranueshme duhet të lidhen me transferimin e njohurive dhe ngritjen e kapaciteteve:

- trajnime në vendin e punës;
- workshop-e;
- shkëmbim stafi / staff secondment;
- vizita studimore;
- misione peer review;
- asistencë për përgatitjen e dokumenteve strategjike, planeve zhvillimore, reformave ose studimeve;
- transfer teknologjie;
- asistencë teknike dhe ngritje kapacitetesh;
- event final për prezantimin dhe promovimin e rezultateve.

Aktivitetet duhet të zhvillohen në shtetet anëtare të CEI.

Periudha e zbatimit të projekteve:

Projektet mund të fillojnë nga 1 janari 2027. Kohëzgjatja minimale është 6 muaj, ndërsa maksimale 24 muaj.

Cili është buxheti i thirrjes për secilën bashki:

Buxheti total i thirrjes është 550.000 euro.

Shuma maksimale e grantit për një projekt që partnerët mund të përfitojnë është 40.000 euro, ose 50% e kostos totale të projektit. Pra, nëse në një projekt kërkohet maksimumi i financimit nga CEI prej 40.000 euro, buxheti total i projektit duhet të jetë të paktën 80.000 EUR. Pjesa tjetër e shumës mbi 40.000 euro duhet mbulohet nga partnerët ose burime të tjera.

Si bëhet aplikimi:

Aplikimi bëhet vetëm online përmes sistemit elektronik të CEI.

Dokumentat e aplikimit duhet të përfshijnë:

- Formularin e Aplikimit Online (Online Application Form);
- Shtojcën 1 – Ndarja e kostove (Annex 1 – Breakdown of costs);
- Shtojcën 2 – Skema e bashkëfinancimit (Annex 2 – Co-financing scheme);
- Shtojcën 3 – Firma e aplikantit (Annex 3 – Applicant's signature).

Çdo aplikant mund të dorëzojë vetëm një projekt-propozim.

Kur është afati i fundit:

Afati i fundit është 11 shtator 2026, ora 12:00 CEST. Rezultatet paraprake për dhënien e granteve parashikohen në fund të nëntorit 2026.

Linku i Thirrjes:

<https://application.cei.int/application/kep-2026/>